



VENDIM

Nr. 144 , Datë 25.06.2018

MBI

RISHIKIMIN E “METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGIJË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT” MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 201, DATË 04.12.2017

Në mbështetje të neneve 16; 19, gërma “b”; 20, gërma “a”; dhe 87,pika 4, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, si dhe nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.06.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoritë Teknike, në lidhje me rishikimin e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, në zbatim të nenit 87, pika 4 të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, me vendimin nr. 201, datë 04.12.2017, miratoi “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”.
- Bordi i ERE-s, me Vendimin nr. 104 date 30.04.2018 miratoi fillimin e procedurave për rishikimin e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me Vendimin nr. 201, datë 04.12.2017 të Bordit të ERE-s.
- Në procedurën e nisur me vendimin nr. 104 date 30.04.2018 për rishikimin e Metodologjise ekzistuese, u propozuan ndryshimet në vijim:
 1. Formula për llogaritese e çmimit FMF në nenin 8 të Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit” miratuar me Vendimin Nr. 201, datë 04.12.2017 të Bordit të ERE-s te jete:

$$\text{ÇFMFt} = \text{CBEt} + \text{Pr} * \text{CBEt} + \text{TRrTSHt} + \text{CA}$$

Ku:

CBEt- Çmimi maksimal i blerjes së energjisë për periudhën e furnizimit nga **Tregu i parregulluar ose blerja nga prodhuesit me perparesi (BRE)**.

Pr – **Kthim per riskun i percaktuar per vitin**

CA- **Kosto administrative te Furnizuesit te Mundesise se Fundit**

2. Pas pikës 8.1, shtohet pika 2 me përmbajtje si më poshtë:

2. Në çdo rast ky çmim nuk do të jetë më i ulët se çmimi i shitjes me pakicë te klientët që furnizohen në atë nivel tensioni sipas Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 148, datë 26.12.2014.

- ERE, me urdhër nr. 38 datë 7.05.2018, organizoi një seancë dëgjimore me përfaqësuesit e OSHEE sh.a, MIE dhe Autoritetit të Konkurrencës.
- OSHEE sh.a. me shkresën nr 8814/1 date 24.5.2018 përcolli komentet në lidhje me ndryshimet e propozuara në Vendimin Nr.104 datë 20.4.2018 të bordit të ERE-s, si më poshtë:
 1. *Rishikimi i Metodologjise dhe arsytet e permendura ne Vendimin e Bordit te ERE, Nr.104, date 30.04.2018, per rishikimin e saj, nuk perkojne me situaten aktuale, sepse:*
 - a. *OSHEE sh.a nuk ka ndarje te llogarive midis aktivitetit te Furnizimit dhe Shperndarjes dhe vijon te mos kete ndarje te tyre edhe sot. Keto llogari vijojne te ndahen aktualisht me metodologjine e dakortuesuar edhe me ERE, deri ne date 01.01.2019, kur OSHEE sh.a do te ndahet si shoqeri.*
 - b. *OSHEE sh.a nuk ka patur nje strukture te posacme per evidentimin e kostove te administrimit dhe kostot e disbalancave kur u miratua Metodologjia ne 04.12.2017 dhe vijon mos ta kete edhe sot.*
 - c. *Pavaresisht se OSHEE sh.a kishte filluar apo jo si FMF, si dhe pavaresisht faktit qe klientet si FMF do te furnizohen per 60 apo 720 dite Metodologjia konsiderohet se duhet te jete e pandryshueshme.*
 2. *Vendosja e nje cmimi minimum mund te ndikojte ne paanesine e Operatorit Publik ne ofrimin e sherbimit te furnizimit me energji elektrike, ne favor te klienteve te 35KV, si dhe mund te rendoje poziten e klienteve te OSHEE sh.a. Vendosja e nje cmimi dysHEME, nuk perkon me aplikimin e nje metodologjie cmimi per klientet ne fjale. Ne kete kuader, jemi te mendimit qe pika 8.2 te hiqet.*
 3. *Ne metodologji jane perfshire elemente te rinj Pr apo CA, por nuk sqarohet se c'perfaqesojne ato ne tarife, rolin e tyre, si dhe menyren e llogaritjes gjate vitit 2018. Ku do te mbeshtetet OSHEE per llogaritjen e tyre, tek te dhenat paraprake qe perdoren gjate aplikimit per tarife, apo ne te dhenat perfundimtare pas konsolidimit te bilancit financiar?*
 4. *Treguesi CBEt i cili perfaqeson cmimin maksimal te blerjes se energjise ne treg te parregulluar apo i blerjes nga PPEE, a do te mund te aplikohet pas vitit 2018, kur energjia e PPEE dote jete kosto per Operatorin e Sistemit te Shperndarjes per mbulimin e humbjeve dhe funksioni i FMF mbetet detyrim funksional i FSHU.*
 - Në lidhje me sa arsyetuar nga OSHEE sh.a., ERE sqaroi se :
 - *Metodologjia e paraqitur eshte pergatitur per te sherbyer per nje periudhe te gjate dhe jo per nje operator te caktuar te furnizimit me energji elektrike si OSHEE sh.a. por ne kushtet e nje shoqerie qe kryen disa funksione dhe me stadin e aktual te organizimit aplikimi i saj eshte problematik.*
 - *“FMF duhet të mbajë llogari të ndara për furnizimin e konsumatorëve sipas shërbimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, nga furnizimi i konsumatorëve nga shërbimi i FSHU (Furnizuesi i Shërbimit Universal) si dhe çdo furnizim tjetër tregtar. Këto të dhëna duhet të jenë në dispozicion të ERE-s sa herë që kërkohet prej saj”.*

- Mosekzistenca në OSHEE sh.a. e strukturës për evidentimin e kostove administrative dhe të disbalancave për konsumatorët e FMF nuk përbën argument. ERE nuk ka penguar në lejimin dhe njohjen e kostove për ngritjen e një strukture të tillë e cila do të ndihmonte në ndarjen e saktë të kostove midis klientëve të FSHU dhe FMF, për sa kohë që ato janë të arsyeshme dhe të justifikuara
 - *“FMF ka detyrimin të blejë energji elektrike me shumicë në emër të konsumatorëve të furnizuar prej tij dhe të jetë përgjegjës për balancimin e mbetjes për një furnizim të tillë me shumicë”.*
 - Zgjatja e afatit të shërbimit nga 60 ditë në 2 vjet krijon lehtësi për përcaktimin e kostove administrative për kWh të furnizuar nga ana e OSHEE sh.a.. Kjo për shkak të krijimit të mundësisë së parashikimit të kostove operative të furnizimit si aktivitet në tërësi për periudha vjetore, e më tej të alokimit të tyre midis klientëve të FSHU dhe atyre të FMF.
 - Në praktikën e deritanishme janë vërejtur interferenca në shpenzimet për blerje energjie ndërmjet funksionit të FMF dhe FSHU.
- ERE në metodologji, siguron mosfavorizim të klientëve të FMF në dëm të klientëve të FSHU nëpërmjet monitorimit dhe kontrollit të vazhdueshëm për përcaktimin e çmimit të furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sikurse parashikohet në pikën 3 të nenit 10 të Metodologjisë.
 - Referimi i një cmimi dysheme për klientët FMF ekuivalent me atë të klientëve në të njëjtat kushte (nivel tensioni, kategori konsumatorësh) të FSHU është i nevojshëm për të shmangur situata të tilla ku cmimi i klientëve FMF rezulton më i ulët, ndërkohë që energjia për këta konsumatorë blihet në treg me cmime që në cdo rast rezultojnë më të larta se miksi i energjisë (KESH 1.5 leke/kWh-Treg) për klientët e FSHU. Kjo si rezultat i pamundësisë/paafësisë së shoqërisë për të paraqitur dhe alokuar të gjitha kostot respektive për shërbimin e klientëve FMF.
 - Siç është sqaruar edhe në vendimin për fillimin e procedurës së disa ndryshimeve të metodologjisë :
 - **CA** - përfaqëson kostot administrative/operative në lekë për cdo kWh të furnizuar nga ana e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit (nënkupton kostot operative, kostot e borxhit të keq dhe koston e kapitalit të punës për aktivitetin e furnizimit)
 - Për përcaktimin dhe axhustimin e CA Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të zbatojë përcaktimet e nenit 6 të metodologjisë i cili parashikon korrigjimin sipas parimit ex-post.
 - **Pr** –përfaqëson kthimin për riskun dhe do të jetë një përqindje fikse e aplikuar mbi koston e blerjes së energjisë nga FMF sipas përcaktimeve në pikën 4 të nenit 6, *e cila duhet t'i kthejë furnizuesit një kthim të arsyeshëm në mënyrë që të kompensojë riskun e tij të furnizimit.* Nisur nga benchmarku apo nga praktikat me të mira ky kthim nuk do të kalojë nivelin prej 3%
 - Referimi tek cmimi i blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi (BRE) përveç tregut të parregulluar pas vitit 2018 për përcaktimin e CBEt (Çmimi maksimal i blerjes së energjisë për periudhën e furnizimit) mbështetet në faktin që sasia e energjisë e blere nga BRE

(sikurse detyron VKM 244) përtej nevojës për mbulimin e humbjeve të OSSH do të kalojë për mbulimin e kërkesës për klientët FMF.

Në përfundim të afatit për marrjen e opinionit dhe vëretjeve të palëve të interesit, në lidhje me ndryshimet e propozuara në Metodologjinë e përcaktimit të çmimit për FMF të cilat janë publikuar edhe në faqen e internetit të ERE-s, nuk ka pasur komente të tjera nga pale interesi (përvec OSHEE Sh.a) apo nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoriteti i Konkurences.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë rishikimin e nenit 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit” miratuar me vendimin nr. 201, datë 04.12.2017 të Bordit të ERE-s, si vijon:

Neni 8 ndryshon dhe bëhet:

- a. Llogaritja e Çmimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit do të bëhet sipas formulës së mëposhtëme:

$$\text{ÇFMFt} = \text{CBEt} + Pr * \text{CBEt} + \text{TRrTSHt} + \text{CA}$$

Ku:

CFMFt Çmimi i furnizimit në periudhën relevante *t*

Ku:

CBEt është çmimi maksimal i blerjes së energjisë për periudhën e furnizimit nga Tregu i parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi. (BRE)

Pr Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (do të pranohet në masën 3% për dy vitet e para e më tej do të rishikohet bazuar në të dhënat historike)

TRrTSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes për periudhën relevante *t*

CA Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit

- b. Në çdo rast ky çmim nuk do të jetë më i ulët se çmimi i shitjes me pakicë të klientët që furnizohen në atë nivel tensioni sipas Vendimit të Bordit të ERE-s Nr.148, datë 26.12.2014, kur kete funksion e ushtron OSHEE/ FSHU

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrotjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.